



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0414

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së OE N.N.P. Wenda, kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi dhe meremetimi i shkollave sipas Lot 1 dhe Lot 2” me numër të prokurimit VU644-22-11569-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Vushtrrisw, më 08/08/2023, mori këtë:

Vendim

1. **Anulohet**, në tërësi aktiviteti i prokurimit “Renovimi dhe meremetimi i shkollave sipas Lot1 dhe Lot2”, me numër të prokurimit VU644-22-11569-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Vushtrrisë.
2. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Ndërsa, obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale

Me 24.10.2022, Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi dhe meremetimi i shkollave sipas Lot 1 dhe Lot 2” me nr. të prokurimit: VU644-22-11569-5-2-1”.

Me datën 06. 06. 2023, AK ka publikuar njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

OE N.N.P. Wenda me datën 07.06.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 20. 06. 2023, AK - Komuna e Vushtrrisë me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të

OE ankues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues N.N.P. Wenda, me datën 19.06.2023 Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0414, kundër njoftimit për anulim të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Vlerësimi dhe administrimi i provave

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 07/07/2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar ndërsa vendimi i AK për anulim të mbetet në fuqi.

OE ankues, i pakënaqur me vendimin e AK-se për anulim të aktivitetit të prokurimit ka parashtruar ankese në OSHP, me pretendimin se nuk janë respektuar kryesisht dispozitat e nenit 62 të LPP-se, lidhur me anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Autoriteti kontraktues – Komuna e Vushtrrisë e anulon këtë aktivitet të prokurimit me arsyetimin se:

Ne deklaratën e dhënë nga autoriteti kontraktues vërehen dy arsye të anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit, njëra arsye është mungesa e mjeteve ndërsa arsyeja e dytë është mungesa e validitetit të ofertave.

Konkretisht për mungesën e mjeteve financiare, AK-ja deklaron se “edhe përkundër angazhimit deri me sot nuk kemi arritur të sigurojmë mjetet për realizimin e këtij projekti pasi që ky projekt ka filluar në vitin fiskal 2022 dhe mjetet janë bartur në buxhetin e Kosovës”.

Ndërsa sa i përket validitetit AK-ja, deklaron se “procesi i vlerësimit të ofertave nuk është finalizuar brenda periudhës së validitetit të ofertave”.

Eksperti shqyrtues sqaron se dy arsyetimet e dhëna nga AK-ja, janë kundërthënëse, sepse nëse mjetet kanë kaluar ne buxhetin e Kosovës, pse autoriteti kontraktues kërkon zgjatjen e vlefshmërisë se ofertave me datën: 23.02.2023, ne kohen kur nuk ka pasur mjete dhe njeherit ofertat nuk kanë pasur validitet sepse validiteti i ofertave ka përfunduar me 03.01.2023, pra kërkesa ne këtë rast ju është dërguar OE-ve pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit, pas skadimit te validitetit e cila është ne kundërshtim me nenin 30.4 te rregullores 001/2022.

Poashtu, AK-ja me datën: 06.03.2023, AK-ja, përsëri ju drejtohet me kërkesë OE-ve, për zgjatjen e validitetit:

Vazhdimi i vlefshmërisë se Tenderit tuaj duhet të bëhet edhe për 60 ditë duke filluar nga data 03.03.2023 deri më dt. 02.05.2023

Ndërsa me datën: 06.06.2023, AK-ja e publikon formularin B58 – vendimin për anulim te këtij aktiviteti te prokurimit.

Eksperti shqyrtues, si shkelje tjetër evidenton faktin se AK-ja me datën: 09.12.2022 e ka publikuar formularin B58 vendimin për dhënie te kontratës ku e ka rekomanduar një tjetër operatore ekonomik, dhe pas pranimit te një kërkesë për rishqyrtim nuk ka vazhduar me vlerësim te ofertave dhe njeherit sqaroje se ne platformën e E-Prokurimit nuk ka asnjë deklaratë me shkrim se pse ka zgjatur kjo procedure rreth 6 muaj dhe nuk ka përfunduar procesi i vlerësimit te ofertave dhe krejt ne fund AK-ja e anulon me arsyetimin e mungesës se validitetit kur dihet qartë se detyre dhe përgjegjësi për te kërkuar zgjatjen e validitetit te ofertave e ka autoritetit kontraktues.

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar ne tërësi te gjitha shkresat e lendes, duke përfshirë pretendimin e OE ankues, rrjedhën e kësaj procedure te prokurimit, vjen ne përfundim se për shkak te prolongimit te këtij procesi nga ana e AK-se është e pamundur te vazhdohet me tutje (pavarësisht pretendimeve te qëndrueshme te OE ankues) sepse validiteti i ofertave ka skaduar me datën: 03.01.2023 dhe me këtë rast AK-ja ka vepruar ne kundërshtim me paragrafin 4 te nenit 30 te Rregullores 001/2022, për faktin se nuk i ka dërguar kërkesat për vazhdim te validitetit para datës se skadimit.

Sa i përket sqarimeve te dhëna me larte, lidhur me shkeljet procedurale te autoritetit kontraktues, i cili me veprimet e veta ka shkaktuar dëme tek operatorët ekonomik pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit, prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues, qe te merr masa ndaj autoritetit kontraktues sipas dispozitave te nenit 130 te LPP-se për faktin se pikërisht mosrespektimi i nenit 30.4 te Rregullores 001/2022 parashihet si shkelje e rende ne nenin 97 pika f e Rregullores 001/2022.

Palët janë njoftuar përmes sistemit të e-prokurimit ku OE ankues nuk është deklaruar për mendimin e ekspertit ndërsa AK është pajtuar.

Konstatimet e Panelit Shqyrtues

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur

sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e OE dhe AK si dhe raportin e ekspertit shqyrtues.

PSH e mbështet anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, sepse në të kundërtën do të bie ndesh me parimet dhe dispozitat e prokurimit publik dhe AK do të vinte në një gjendje ku do ta kishte të pamundur nënshkrimin e kontratës pa i pasur mjetet në dispozicion, ngase në bazë të shkresave dhe arsyesimit të dhënë nga AK nuk ka arrit të siguroj fondet për këtë aktivitet të prokurimit.

Sipas nenit 8.3 të RRUOPP, citat: *“Nëse AK është autoritet publik ose organizatë buxhetore ZKF do të siguroj që: a. Fondet janë alokuar; ose b. Fonde të mjaftueshme do të alokohen në vitin fiskal në fjalë. Kjo dispozitë do të përfshihet në kontratën publike.”*

Paneli shqyrtues e lenë në fuqi vendimin e AK-së sa i përket anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe e njofton AK dhe menaxherit të prokurimit se OSHP do të luaj rol aktiv dhe do ta mbikëqyr në rast të ri-shpalljes së këtij aktivitetin e prokurimit në fjalë dhe nëse vërtetohet që nuk qëndrojnë deklaratat e përfaqësuesve të AK-së sa i përket mungesës së mjeteve për aktivitetin e prokurimit në fjalë, Organi Shqyrtues i Prokurimit në pajtim me nenin 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së, do të kërkoj nga KRPP-ja, që ti anulohet licenca e prokurimit menaxherit të prokurimit të autoriteti kontraktues Spitali Ferizaj.

Paneli shqyrtues me marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

- Përfundim -

Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bje ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: *“...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”*.

Me qenë se ky aktivitet i prokurimit anulohet pa fajin e operatorëve ekonomik, Vendimi sikurse në pikën 2, të dispozitivit është marrë ne kuptim te nenit 31, paragrafi 6, i Rregullores se punës se Organit Shqyrtues të Prokurimit

Paneli Shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRISË**
- **OE - N.N.P. Wenda**
- Arkivës së OSHP-së: